

Isak A H M E T I

**RRJEDHA E NJË MANIFESTIMI KULTUROR – LETRAR -  
SHKENCOR**

Takimet e dom Mikelit (1990-2024)

Monografi

(me rastin 35 vjetorit)

**SHB LENAGRAPHIC**  
Prishtinë, 2024

Isak Ahmeti

**Rrjedha e një manifestimi kulturor – letrar – shkencor**

Takimet e dom Mikelit (1990-2024)

Monografi

(me rastin 35 vjetorit)

Redaktor: Zef Noka

Shtëpia botuese:

**LENAGRAPHIC**

Prishtinë, 2024

## **Përmbajtja**

DY FJALË NË FILLIM .....	5
NË VEND TË HYRJES .....	7
TAKIMET E DOM MIKELIT (1990-2024).....	9
I. Historiku i Takimeve .....	9
II. Manifestim jo vetëm kombëtar .....	10
III. Takimet e dom Mikelit sipas imzot N. Preles.....	12
<i>Takimet e dom Mikelit në frymën e traditës kishtare dhe popullore</i> .....	12
IV. Imzot Nikë Prela dhe Takimet.....	14
V. Dom Mikeli – Simbol i qëndresës shqiptare .....	15
VI. Këshilli Organizativ i Takimeve.....	16
VII. Takimet si manifestim kulturoro-shkencor .....	19
VIII.Akademia shkencore dhe ora e madhe Letrare... 21	
1) <i>Akademia shkencore</i> .....	21
2) <i>Ora e madhe letrare</i> .....	30
SHËNIMET E PËRVJETORËVE .....	69
SHTOJCË:.....	71
FOTO TË PËRZGJEDHURA NGA TAKIMET E DOM MIKELIT .....	71
SHËNIME PER AUTORIN .....	77



## DY FJALË NË FILLIM

*TAKIMET E DOM MIKELIT NË STUBËLL*: shtator 1990-  
shtator 2024.

Organizator: *KËSHILLI ORGANIZATIV I TAKIMEVE* të Dom.  
Mikelit në Stubëll.

Shtator 2024. Edicioni i 35-të i Takimeve të Dom Mikelit shënon një vit jubilar të rëndësishëm dhe fatbardhësisht të mbushur me arritje! Megjithatë, duhet pranuar me keqardhje se, pavarësisht përpjekjeve dhe propozimeve të mia të vazhdueshme brenda KOTDM, nuk është pranuar ideja për të realizuar një monografie-rikujtesë për këto Takime, të cilat tashmë kanë zënë vend të merituar si një institucion i njohur kulturor, letrar dhe shkencor mbarëkombëtar.

Në mungesë të një konsensusi të përbashkët, ndjej detyrimin që, si një ndër ideatorët, themeluesit, organizatorët dhe anëtari më i vjetër i këtyre Takimeve dhe i KOTDM-së që nga fillimet e tij, të ndërmarr hapin e hartimit të kësaj monografie. Ky projekt është një përpjekje modeste, por e sigurtë, për të ruajtur kujtesën dhe për të lënë një gjurmë të qëndrueshme mbi këtë udhëtim të pasur e të vyer. Kjo monografi, e hartuar kështu dhe në këtë mënyrë, nuk pretendon të jetë gjithëpërfshirëse. Megjithëkëtë, vlerësoj unë, në të kemi një paraqitje mjaft solide, reale dhe objektive dhe, si e tillë

që është, besoj, plotëson sadopak një zbrazëtirë që ka ekzistuar deri më tash.

Në monografi është paraqitur, ndonëse në formë të shkurtër, gjithë ajo çka kemi bërë si Këshill Organizativ, çka është zhvilluar dhe referuar(lexuar) në AKADEMINË SHKENCORE dhe në ORËN E MADHE LETRARE-dy pjesët kryesore të Programit të Takimeve që nga fillimi (1990) e deri më 2024.

*Në Stubëll, shtator-tetor 2024. Autori*

## NË VEND TË HYRJES

Stublla, fshat me një histori të veçantë, interesante dhe të lavdishme, përmendet qysh në vitin 1477. Në hartën topografike të Shkupit përmendet Caravajka, që gjendet në verilindje të Stubllës. Stublla këtu, në këtë dokument, në këtë hartë topografike është marrë si pikë orientimi gjë që flet dhe dëshmon shumë.<sup>1</sup>

Tri janë ngjarjet kryesore që e karakterizojnë historinë e lavdishme të Stubllës :

1. *Shkolla Shqipe* (1584-1905),
2. *Martirizimi i banorëve shqiptarë katolikë të katër fshatrave të Malësisë së Karadakut* (Stubllës, Binçës, Vërnakollës dhe Terziajve) 1846-1848 dhe
3. *Takimet e Dom Mikelit*(1990-2024).

Kur flasim për Stubllën është me rëndësi të theksohet edhe fakti se nga gjiri i saj, siç kanë theksuar shumë studiues, një ndër ta edhe Ndue Ukaj, kanë dalë pena që njihen anë e kënd botës shqiptare, por edhe më gjërë, si Dr. Don Lush Gjergji, Dr. Don Gjergj Gjergji-Gashi, Prof. Dr. Engjëll Sedaj, Isak Ahmeti e të tjerë të gjeneratës së re që janë në këtë linjë.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> Krhs. Monumenta Trurcica 21, Sarajevë, 1972, fq.127, 156.

<sup>2</sup> Krhs. Ndue Ukaj, Stublla, monografi, fq.88.

Ç' është e vërteta, ashtu siç e gjen uji rrjedhën e vet, edhe Takimet e Dom Mikelit, falë përkushtimit dhe angazhimit të pa rezervë të KOTDM, ato janë formësuar, janë zhvilluar gjatë 35 viteve duke lëshuar vazhdimisht shtat e rritë, duke marrë kështu trajtën dhe fizionominë e Takimeve të vërteta historike, kulturore, letrare dhe shkencore. Për më tepër, ato kanë shkëlqyer, kur më pak e kur më shumë, me bukurinë e madhështinë e tyre, me fisnikërinë e bujarinë, me mikpritjen e zemërngrohtësinë, me etnologjinë e folklorin, me këngë e valle burimore, me humorin e zemrën e madhe të qytetarëve të këtij lokaliteti i njohur ndër shekuj...

Ka me qindra shkrime në shqip dhe gjuhë të huaja për Stubllën martire: në libra, buletine, revista, gazeta, simpoziume e tribuna. Është shkruar dhe botuar edhe monografia: STUBLLA, grup autorësh nga Stublla, editor Dom Fatmir Koliqi.

Janë botuar edhe dy monografi për Martirët dhe një për Shkollën e Stubllës:

1. Gjergj Gj. Gashi: MARTIRËT SHQIPTARË GJATË VITEVE 1846-1848, Drita, Ferizaj, 1994 dhe
2. Isak Ahmeti: GOLGOTA E MARTIRËVE SHQIPTARË TË KARADAKUT (1846-1848), LENA, Prishtinë, 2021 dhe
3. Sarë Gjergji: STUBLLA ME SHKOLLËN E PARË SHQIPE (1584-1905), Lidhja e Shkrimtarëve e Kosovës, Prishtinë, 2014.



## **TAKIMET E DOM MIKELIT (1990-2024)**

### **I. Historiku i Takimeve**

Që në fillim të këtij libri monografik është me shumë rëndësi të theksohet për hir të së vërtetës se pas konsultimit me Imzot Nikë Prelën, që me rezidencë ishte në Ferizaj, unë, Dom Lush Gjergji dhe Dom Rrok Gjonlleshaj, atëherë famullitar i ri i sapo emëruar në Stubëll (20. 09. 1989), kemi shkuar në Prishtinë (ishte dita e helmimeve të nxënësve dhe studentëve!) dhe fillimisht jemi takuar dhe konsultuar me Dr. Ibrahim Rugovën, atëherë kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, të cilin e kisha shok dhe mik që nga koha e studimeve (1969-1973). Pas takimit, këshillimit dhe përkrahjes të Dr. Rugovës në lidhje me idenë tonë për të organizuar manifestimin kulturor, letrar dhe shkencor në shenjë kujtimi dhe nderimi të Dom Mikelit, kemi shkuar në Institutin Albanologjik ku unë, por jo edhe dy shoqëruesit e mi, kisha shumë miq dhe bashkëpunëtorë dhe aty kemi biseduar gjerë e gjatë për idenë dhe mënyrën e organizimit të Takimeve të Dom Mikelit. Më pas, sipas idesë dhe propozimit të Dr. Rugovës, që atëherë ishte lideri në lindje i shqiptarëve të Kosovës, unë dhe Dom Rroku, me golfin tim që e kisha atëbotë, kemi shkuar në Prelepnice të Gjiilanit, te Sami Shabani, skulptor, me të cilin po atë ditë jemi marrë vesh për ta bërë bustin e Dom Mikelit, që tashmë, vepër e përkryer, gjendet në oborrin e Kishës së Vjetër në Stubëll, ku ka funksionuar Shkolla Shqipe e Dom

Mikelit (1905), legalizuar nga Austrohungaria falë angazhimit dhe intervenimit të Dom Mikelit, famullitar dhe mësues...

## **II. Manifestim jo vetëm kombëtar**

Pas suprimimit dhe okupimit me dhunë dhe tanke të autonomisë së Kosovës nga serbosllavia, në Stubëll të Vitisë, më 22 shtator të vitit 1990, është mbajtur manifestimi më i madh kulturor, letrar dhe shkencor në Kosovë, ku që nga fillimi e deri më sot, kanë marrë pjesë mijëra njerëz të shtresave, kategorive dhe profileve të ndryshme nga Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia (e Veriut), Austria, Sllovenia, Kroacia, SHBA, etj.

Vlen të theksohet së nën përkujdesjen dhe angazhimin e përkushtuar të anëtarëve të KOTDM, kush më pak e kush më shumë, përkundër mospajtimeve, diskutimeve dhe polemikave që kemi pasë herë pas here,<sup>3</sup> ka kontribuar që ky manifestim, megjithëkëtë, të jetë, vazhdimisht, shprehje e dijes, moralit, urtësisë e kujtesës nacionale dhe rezistencës kundër okupimit serbosllav. Madje, jo rastësisht në njërin nga TAKIMET E DOM MIKELIT, me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, ku pat marrë pjesë edhe ambasadori i atëhershëm i Shqipërisë në Kosovë, Islam

---

<sup>3</sup> P.sh. rasti, për mua më i pakuptimt dhe i panevojshëm mes Dom Rrokut dhe Prof. Engjëll Sedajt.

Llauka ka thënë se këtu, në Takimet e Dom Mikelit, në Stubëll, është proklamuar publikisht Republika e Kosovës.

Manifestimi i parë, siç dihet tashme, është hapur me poezinë : SHKOLLËS SË PARË SHQIPE të *Isak Ahmetit*, të cilën e ka deklamuar, me një intonacion solemn, *Zef Ahmeti*, të cilën po e japim këtu në tërësi.

### **SHKOLLËS SË PARË SHQIPE NË KOSOVË**

*(Në Stubëll, 22 shtator 1990).*

Imzot Pashk Trokshi me dorë Dekretin shkroi  
Dom Mikelin në Stubëll e caktoi famullitar,  
E Trimi Meshën çoi, Ungjillin shqip lexoi,  
Popullin për liri e nxiti-doli fitimtar.

Nga Letnica në famullinë këtu, pra, erdhi,  
I urti prift-pishtar arsimi - trim me fletë.  
Dije e djersë n`këtë tokë martire ai derdhi.  
Çetën e Martirëve t'Karadakut këtu ka gjetë.

Këtu, n' këtë Kishë të Shën Gjergjit, meshtari  
Hapi Shkollën Shqipe. S'e ndali as litari.  
Ja këtu rilindën Shkronjat, zëshëm ato shqiptoi .  
E burgosën, por gjuhën e të Parëve s'e harroi.

E burgosën, e munduan, mizorisht e masakruan.  
Udhën e Shkronjave trimi s' lëshoi.  
Burrat e urtë të Karadakut fort e çmuan.  
Me Çetën e profetëve brezat frymëzoi.

Thonë edhe Idriz Seferin e kishte mik,  
Oso Kukën e Dedë Gjo Lulin frymëzim,  
Burra t'zgjedhur t'k'saj ane pat nisur n' Kaçanik  
Për t'luftuar për Liri-për Popull-për Ngadhënjim.

E pra Fjala e Drita me vrull këtu shpërtheu,  
U valëvit rrufeshëm Famuri, ngadhënjimtar.  
Lirinë e gjeta këtu -pat thënë Skënderbeu-  
E ju djem e vasha, shkoni, shkoni Rrugës së parë!

### **III. Takimet e dom Mikelit sipas imzot N. Preles**

*Takimet e dom Mikelit në frymën e traditës kishtare dhe  
popullore<sup>4</sup>*

Fytyra e ndritshme e famullitarit të Stubllës, Dom Mikel Tarabulluzit, të cilin po e përkujton Kisha e jonë dhe mbarë populli me rastin e 100-vjetorit të shugurimit të tij meshtar, do shndrisë në të gjitha dimensionet e jetës së krishterë. Ky pishtar i arsimit dhe kulturës, mësuesi i Shkollës së Parë

---

<sup>4</sup> Fjala përshëndetëse e Imzot Nikë Prelës në Takimet e Dom Mikelit, Buletini, TAKIMET E DOM MIKELIT(1990-1992), 1994.

Shqipe në Stubëll, i përvuajtur dhe i urtë me fjalë dhe në vepra, do të jetë shëmbëlltë e jetës patriotike, që karakterizonte klerikët tanë gjatë shekujve të errët të së kaluarës së hidhur.

Zbulimi i bustit të këtij prifti shqiptar shënon gjithashtu një datë të rëndësishme, kur edhe ne të gjithë duhet t'i kthehemi e të studiojmë e ta kuptojmë sa më mirë traditën tonë të lavdishme, që me vepra në jetën e përditshme ta ndjekim rrugën e Zotit, ashtu siç na mëson e vërteta ungjillore.

Në këtë rast përshëndesim iniciativën e Këshillit Organizativ që në të ardhmen këto Takime të bëhen tradicionale dhe të bartin emrin e DOM MIKELIT, pa dyshim, rilindasit më të madh të Malësisë së Karadakut. Do të përkrahim gjithashtu çdo iniciativë, që në forma të organizuara dhe me motive paqedashëse do të avancojë zhvillimin e mendimit shkencor dhe kulturor të Anamoravës dhe veçanërisht të Malësisë së Kadadakut. Në këtë drejtim përshëndesim Këshillin Organizativ të këtyre Takimeve që të nxjerrin dhe botojnë Buletinin e tyre për t'i publikuar, qoftë edhe në formë të shkurtër, ato aktivitete dhe ato referate që janë mbajtur në Takimet e mëparshme. Kjo do të jetë edhe një dëshmi e kohës sonë dhe rezultat i përpjekjeve të atyre që janë të bindur se me aktivitete dhe me durim të madh mund të përballohen pengesa të shumta.

#### **IV. Imzot Nikë Prela dhe Takimet**

Është me shumë rëndësi të theksojmë se Imzot Nikë Prela, ipeshkëv *sedi datus* për Kosovën, që nga fillimi ka përkrahë, pa rezervë, jo vetëm grupin nismëtar por edhe KOTDM. Madje ai ka qenë vazhdimisht jo vetëm inkurajues dhe frymëzues, por edhe motivues për mbarëvajtjen e Takimeve.

Vlerësimi i Imzot Nikë Prelës për Takimet e Dom Mikelit, përkatësisht për grupin nismëtar dhe KOTDM, ka qenë jo vetëm përkrahje, por edhe inkurajim, motivim dhe frymëzim i vazhdueshëm për të ecur përpara dhe për të arritur sa më shumë rezultate të reja.

Në këtë kontekst, le të ripërsërisim këtu, edhe njëherë, atë çka na ka porositur Imzot Nikë Prela, kur ka thënë, citojmë: *“Në këtë rast përshëndesim iniciativën e Këshillit Organizativ (nënvizimi im), që në të ardhmen këto Takime të bëhen tradicionale dhe të bartin emrin e DOM MIKELIT, pa dyshim rilindësit më të madh të Malësisë së Karadakut. Do të përkrahim gjithashtu çdo iniciativë, që në forma të organizuara dhe me motive paqedashëse, do të avancojë zhvillimin e mendimit shkencor dhe kulturor të Anamoravës dhe veçanërisht të Malësisë së Karadakut. Në këtë drejtim, prandaj, përshëndesim iniciativën e Këshillit Organizativ të këtyre Takimeve që të nxjerrin e të botojnë Buletinin e tyre për të publikuar, qoftë edhe në formë të shkurtër, ato aktivitete dhe ato referate që janë mbajtur në Takimet e*

*mëparshme... Kjo do jetë edhe dëshmi e kohës sonë dhe rezultat i përpjekjeve të atyre që janë të bindur se me aktivitet dhe me durim të madh mund të përballohen pengesa të shumta".*

Ç'është e vërteta këtij rekomandimi iu ka përmbajtur KO-i Takimeve dhe, falë angazhimit dhe kontributit të veçantë të Prof Engjell Sedajt, Sarë Gjergjit, pa harruar këtu edhe kontributin tim, janë nxjerrë dhe botuar disa nga numrat e parë të *Buletinit* që janë të një rëndësie të veçantë. Mirëpo pas kalimit në amshim të Prof. Engjëllit, ka vazhduar, me shumë zell dhe përkushtim, Sarë Gjergji, përgatitjen dhe botimin jo vetëm të *Buletinit*, por më pas edhe botimin e revistës shkencore me titull: *ACADEMIA STUBLLAE* që është po ashtu kontribut i çmueshëm në vazhden e realizimit të idesë dhe rekomandimit të Imzot Nikë Prelës.

## **V. Dom Mikeli – Simbol i qëndresës shqiptare ...**

Prof.dr. Engjell Sedaj, te shkrimi i tij me titull "*SHKOLLA E PARË SHQIPE DHE MËSUESI I SAJ DOM MIKEL TARABULLUZI*"<sup>5</sup>, duke iu referuar një shkrimi tim, shkruan,<sup>6</sup>citojmë: "*Fytyra e tij e ndritshme (sic. Dom Mikelit - Isak Ahmeti), ndonëse ende e pastudiuar mirë, ka zgjuar interesim te studiuesit e zellshëm stubllanë si Isak Ahmeti, Dom Gjergj Gjergji,*

---

<sup>5</sup> Botuar te *Buletini* (1990-1992), botues Zyra e Famullisë në Stubëll, 1994, fq.22

<sup>6</sup> Isak Ahmeti, *SHKOLLA E PARË SHQIPE NË KARADAK*, Rilindja, 15.V.1970.

*Engjëll Koliqi, Franë Gjergji, Sarë Gjergji dhe të tjerë", dhe është bërë simbol i qëndresës shqiptare.*

Për më tepër, Dom Mikel Tarabulluzi nuk është vetëm simbol i qëndresës por edhe simbol i arsimit dhe edukimit, personalitet historik i çmuar dhe i dashur i popullit të vet, bashkëpunëtor besnik i Idriz Seferit, kreshnikut të Karadakut e strategut ushtarak në udhëheqjen e vullnetarëve kundër robërisë shekullore të Perandorisë Osmane, duke luajtur rol të rëndësishëm e vendimtar në Lëvizjen Gjithëkombëtare në Kazanë e Gjilanit .

Është me rëndësi të theksohet këtu se në Stubëll, edhe para shkollës së Dom Mikelit të vitit 1905, ka pasur shkollë shqipe, për të cilën kanë shkruar jo vetëm studiuesit shqiptarë si Dhimitër S. Shuteriqi, Jashar Rexhepagiqi, akademik Hajrullah Koliqi, etj. por edhe studiuesit e huaj. Për më tepër, edhe sipas Fjalorit Enciklopedik Shqiptar të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, 2008, fq.116, rezulton të ketë qenë Kolegji i Shën Lukës në Stubëll (1584), ndër më t 'vjetrit në trevat shqiptare.

## **VI. Këshilli Organizativ i Takimeve**

Për organizimin, mbarëvajtjen, imazhin, fizionominë dhe suksesin e TAKIMEVE të DOM MIKELIT, si MANIFESTIM KULTUROR, LETRAR DHE SHKENCOR mbarëkombëtar, që nga fillimi (shtator 1990 - shtator 2024), është kujdesur,



madje me shumë përkushtim, KËSHILLI ORGANIZATIV I TAKIMEVE, përkatësisht anëtarët e Këshillit organizativ, kush më pak e kush më shumë, sipas mundësive, afinitetit dhe aftësisë, legalisht dhe zyrtarisht, me ingerenca të barabarta, që fillimisht është kryesuar nga famullitari i atëhershëm, Dom Rrok Gjonlleshaj dhe më pas nga famullitarët e tjerë që kanë shërbyer në Famullinë e Shën Jozefit në Stubëll siç janë: Dom Herbert Berisha, Dom Aleksandër Kola, Dom Albert Jaku, Dom Jeton Thaqi dhe së fundmi aktualisht Dom Fatmir Koliqi.

Sipas një marrëveshjeje dhe një vendimi të marrë që në fillim të themelimit të KOTDM është thënë në mënyrë taksative se KOTDM do ketë kryesues dhe jo kryetar. Legalisht KOTDM kurrë nuk ka pasë kryetar, por vetëm kryesues, ndonëse herë pas here ka pasur tendenca që ndonjëri nga anëtarët e Këshillit si p.sh. Dom Rrok Gjonlleshaj, Prof.Engjëll Sedaj, Don Jeton Thaqi e ndonjë tjetër anëtar i Këshillit, të paraqitet në opinion si kryetar dhe organizator i Takimeve gjë që nuk është e vërtetë dhe kjo, sipas vlerësimit tim, ka shkaktuar jo vetëm komentime, pakënaqësi, mosmarrëveshje, përplasje por edhe reagime serioze brenda Këshillit (rasti më i ashpër ai midis Dom Rrokut dhe Engjëll Sedajt që është një histori e veçantë!).Për këto dhe fenomene të tjera jo të mira dhe e që lënë një ndjenjë jo të mirë, herë pas here, në mënyrë shumë të moderuar dhe kulturuar, kam reaguar unë i vetmi, privatisht po se po por edhe publikisht më qëllim të tejkalimit të situatave të papëlqyeshme!...

Sipas evidencës time dhe shënimeve që i kemi te Buletini TAKIMET E DOM MIKELIT(1990-1992), 1994, Botues: Zyra e Famullisë në Stubëll të Epërme (Viti), redaktorë: Engjëll Sedaj dhe Zejnullah Halili, del të këtë genë fillimisht kjo përbërje e Këshillit Organizativ:

1. Dom Ndue Gjergji, vikar gjeneral i Ipeshkvisë së Kosovës,
2. Dom Rrok Gjonlleshaj, famullitar në Stubëll,
3. Mr. Mehmet Halimi, bashkëpunëtor i Institutit Albanologjik në Prishtinë,
4. Jonuz Fetahaj, kryeredaktor i "Shkëndijës",
5. Marjan Ukaj, drejtor i shkollës në Stubëll të Epërme,
6. Milazim Krasniqi, sekretar i SHSHK,
7. Isak Ahmeti, shkrimtar,
8. Zejnullah Halili, shkrimtar,
9. Ndue Ballabani, bujk,
10. Demush Zefi, gazetar,
11. Zahide Ukaj, shkrimtare,
12. Qeshk Sh. Ukaj, arsimtar në Stubëll,
13. Kristë Ramaj, jurist,
14. S arë Gjergji, profesor,
15. Franë Gjergji, profesor,
16. Dr. Engjëll Sedaj, profesor i Universitetit në Prishtinë.

Me rrjedhën e kohës dhe ngjarjeve në Kosovë, kjo përbërje ka ndryshuar, herë pas here, kur për shkaqe objektive kur për shkaqe subjektive që tashmë dihen!

I vetmi që kam mbetur, që nga fillimi e deri më sot, jam unë, Isak Ahmeti, i njohur jo vetëm në rrafshin kombëtar si poet, përkthyes letrar nga gjuha gjermane dhe italiane, si shkrimtar dhe studiues i letërsisë, por edhe si autor i shumë veprave zhanresh të ndryshme...

## **VII. Takimet si manifestim kulturoro-shkencor**

Për Takimet e DOM MIKELIT kanë shkruar me dhjetëra e dhjetëra autorë: gazetarë, politikanë, shkrimtarë, studiues dhe punonjës shkencorë profilesh të ndryshme dhe ato në përgjithësi janë cilësuar dhe vlerësuar lart. Te kumtesa e tij me titull: *TAKIMET E DOM MIKELIT MANIFESTIM KULTURORO-SHKENCOR I INSTITUCIONALIZUAR TRADICIONALIST*, Prof. dr. MEHMET HALIMI, njëri nga pjesëmarrësit më të rregullt, që nga fillimi, të këtyre Takimeve, ndër të tjera, shkruan kështu, citojmë: *"...Më kujtohet si sot, kur para katërmëdhjetë vjetësh (më 1990), u përhap lajmi gjithandej Kosovës se në Stubëll të Epërme do të organizohet një tubim i madh, ku do flasin priftërinj e intelektualë, ku do marrin pjesë një popull i tërë të një gjaku e të një gjuhe, të një historie e të një kulture të përbashkët, të një synimi e qëllimi, të një ideali kombëtar- çlirimi nga çizmja shekullore serbe...*

*Jehonë të madhe atëbotë kishte bërë anembanë Kosovës LEVIZJA Gjithë popullore për Pajtimin e Gjaqeve, së cilës i printe plaku dhe intelektual i urtë-profesor Anton ÇETTA, tok me rininë e Kosovës, me mbarë popullin dhe*

*përfaqësuesit e tij kombëtar e fetar, me Dom Lush Gjergjin, myderis Idriz Kosovën e shumë të tjerë patriotë e liridadhës. Jehona e kësaj lëvizjeje gjithëkombëtare e kishte nxit tërë popullin t'ia mësynte Stubllës martire.- Karadakut krenar. U derdh mori turmash nga të gjitha anët. Mirëpo, pushteti hegjemonist barbar serb, i frymëzuar nga shovinizmi i kryekriminelit S. Millosheviq kishte urdhëruar policinë t'i zinte të gjitha shtigjet, por mbi të gjitha kishte zënë grykën e rrugës brrylore, që shpiente për në Stubëll. Gjithkrah shihje policë me fytyra të vrazhdëta, me helmetë blu në kokë, të armatosur deri në dhëmbë, duke na u kërcënuar-- Ndalohet rreptësishtë shkuarja me automjete në tubimin e Stubllës. Atëherë ishim të detyruar të ngjiteshim këmbë rrugës lake-luke nën përcëllimën e diellit të shtatorit vjeshtor dhe kërcënimin të vrazhdë policor. Mezi arritëm pas një ore te kisha-Shkolla e Parë Shqipe, ku po zhvillohej manifestimi gjithëpopullor, i rrethuar me tanke e policë të armatosur ding, të cilët kërkonin edhe më të voglin shkas për ta sulmuar turmën e popullit e për ta shpërndarë tubimin, e çka do të ndodhte me atë rast, dihet.*

*Në këso kushte e rrethana tepër të vështira, me maturi e urti të prijësve tanë, u zhvilluan TAKIMET E PARA TË DOM MIKELIT, nën tytën e topave dhe automatikëve të armikut. Mirëpo, ashtu siç e gjen uji rrjedhën e vet edhe takimet u formësuan, u zhvilluan gjatë këtyre viteve duke lëshuar shtat e rritë, morën trajtën e fizionominë e Takimeve të vërteta historike, kulturore, letrare, shkencore e kombëtare duke u bërë tradicionale, ato shkëlqyen me bukurinë e*

*madhështinë e tyre, me fisnikërinë e bujarinë, me mikpritjen e zemërngrohtësinë, me etnologjinë e folklorin, me këngë e valle, me humorin e zemrën e madhe të malësorëve të kësaj tërthoreje...”.*

## **VIII. Akademia shkencore dhe ora e madhe Letrare**

Pjesë kryesore, substanciale, e programit të Takimeve të Dom Mikelit, që nga themelimi e deri më tash (shtator 2024) ka qenë: 1. *Akademia shkencore* dhe 2. *Ora letrare*, pa harruar këtu të përmendim edhe pjesën e tretë të programit të *TAKIMEVE*, pjesën kulturore-artistike - muzikore (këngë dhe valle të përzgjedhura), që i kanë dhënë një sharm të veçantë këtij manifestimi.

### *1) Akademia shkencore*

Është me shumë rëndësi të theksojmë se në *Akademinë shkencore*, organizuar dhe mbajtur me shumë kujdes dhe përkushtim, që nga shtatori i vitit 1990 e deri në shtator të vitit 2024, kur është mbajtur edhe manifestimi jubilar (edicioni i XXXV-të), kushtuar 80 vjetorit të lindjes së Presidentit historik të Kosovës, Dr. Ibrahim Rugovës, janë trajtuar tema nga më të ndryshmet nga fusha e filozofisë, etnografisë, sociologjisë, letërsisë, politikës etj. Këtu kanë referuar emra të njohur, studiues dhe shkencëtarë nga më të njohurit të botës shqiptare. Temat që janë trajtuar në kanë qenë të përzgjedhura dhe të caktuara me shumë

kujdes dhe përkushtim nga Këshilli Organizativ i Takimeve. Natyrisht se edhe referuesit, që është një armatë e tërë, kanë qenë të përzgjedhur dhe të caktuar po ashtu nga Këshilli Organizativ.

Temat e trajtuara në *Akademinë shkencore* (1990-2024) janë nga më të ndryshmet dhe shumë interesante. Le të shohim në vijim:

### **1990**

1. Takimet e Dom Mikelit-në frymën e traditës popullore (referues Imzot Nikë Prela),
2. Historia e Famullisë së Stubllës (referues Don Ndue Gjergji),
3. Shkolla e parë shqipe dhe mësuesi i saj Dom Mikel Tarabulluzi (referues Prof.dr. Engjëll Sedaj),
4. Vëllezërit Dom Mikel e Jak Tarabulluzi si mësues në Stubëll (referues Prof. Jak Mita).

### **1991**

1. Periudha e punës nismëtare në arsim (referues Mehmet Gjevori),
2. Shkolla në rajonin e Anamoravës (referues Tahir Berisha),
3. Tre qirinj për një kauzë kombëtare 1929-1940 (referues Dr. Hakif Bajrami).

### **1992**

1. Figura e Dom Mikelit-pishtar i arsimit (referues Akademik Mark Krasniqi),

2. Jak Tarabulluzi - tregtar, mësues-veprimtar (referues Prof. Jak Mita).

### **1993-1994**

1. Duke zbatuar amanetin e Dom Mikelit (referues Don Rrok Gjonlleshaj),
2. Disa karakteristika muziko-poetike në Stubëll (referues Dr. Rexhep Munishi),
3. Disa tipare etnografike të Karadakut (referuese Dr. Drita Statovci),
4. Njeriu bashkëkohor (referues Dom Prekë Lazri),
5. Engjëll Zefi-mësues dhe patriot i madh (referues Kristë Ramaj),
6. Riza Maksuti - instrumentalist popullor (referues Dr. Rexhep Munishi),
7. Rrugët e zhvillimit të letërsisë shqipe në Kosovë (referues Isak Ahmeti ),
8. Një botim me vizion të qartë (referues Mr. Mehmet Halimi),
9. Çështje të onomastikës së Malit të Zi të Shkupit (referues Dr. Rexhep Doçi),
10. Lërimi i shqipes dhe shkollave shqipe në Kosovë(referues Sarë Gjergji), .
11. Gurrë e krijimtarisë popullore (referues Engjëll Koliqi).

### **1997-1999-2003**

- 1 Veprimtaria e dendur e një monsinjori shqiptar (referues Engjëll Sedaj ),

2. Martirët e Karadakut - frymëzim fetaro-kombëtar (1846-1848), (referues Dr. Dom Lush Gjergji),
3. Përhapja e krishterimit në Dardaninë antike (referuese Dr. Exhlale Dobruna-Salihu),
4. Dy jubile:2000 vjetori i krishterimit dhe 10 vjetori i Takimeve të Dom Miikelit (referues Imzot Mark Sopi),
5. Vinçenc Gjini, Ejani t'i këndojmë Zoti (referues Sami Piraj),
6. Shqiptarët në mileniumin e ri vështruar nga aspekte etnokulturore (referues Engjëll Sedaj),
7. Monumentet e kultit katolik gjatë Mesjetës në Kosovë (referues Prof.Dr. Jahja Drançolli),
8. Shkolla e Stubllës - Guri i Qoshës së këtij gurthemeli (referues Danish Bebeziqi & Matish Gjeluci),
9. Rreth origjinës së toponimit Stubëll (të Vitisë), (referues Prof.Dr. Shefki Sejdiu ),
10. Muzika në "lojën e filxhanave" në rrethin e Karadakut (referues Dr. Rexhep Munishi),
11. Nëna Tereze - personaliteti më i pakontestueshëm i shek.XX (referues Prof.Dr. Shefki Sejdiu),
12. Mbi veprimtarinë shkencore, kulturore dhe pedagogjike të Prof.Dr. Engjëll Sedajt (referues Prof.dr. Agim Vinca),
13. Diaspora shqiptare e Amerikës dhe çështja e Kosovës në dekadat e para të shek. XX (refetues Prof.Dr. Valentina Duka),
14. Kriptokristianizmi (Krishterimi i fshehtë) (referues Prof. Sarë Gjergji) dhe
25. Kuvendi i Arbërit (referues Prof Dr. Ferit Duka).



## **2009-2010--2012-2017-2018**

1. Nënë Tereza në 100 vjetorin e lindjes (referues Dr. Dom Lush Gjergji),
2. Martirët e Famullisë së Stubllës (referues Prof.Dr. Jahja Drançolli),
3. Gjon Pali II personalitet i tolerancës dhe i mirëbesimit (referues Dr. Jakup Krasniqi,
- 4.Papa Gjon Pali dhe çështja e Kosovës (referues Jusuf Buxhovi),
5. Papa Gjon Pali II -mik i madh i popullit shqiptar (referues Prof.DR. Eqrem Zenelaj)
6. Fillet e arsimit shqip dhe kontributi i klerit katolik (referues Doc.Dr. Astrit Memia),
7. Tri shtigje krijuese të Isak Ahmetit: poezia-përkthimi-shkenca (referues Prof.Dr. Shyqri Galica).
8. Bibla në Letërsinë Shqiptare(referues Isak Shema)
9. Besimi në fjalë (referues Ali Podrmja),
10. Jeta dhe vepra e Zejnullah Halilit(referues Prof.dr. Agim Deva),
- 11.*Takimet e Dom Mikelit* - manifestim kulturoro-shkencor i institucionalizuar tradicionalisht (referues Prof.dr. Mehmet Halimi ),
12. Gjergj Kastrioti -Skënderbeu dhe Kosova (referues Prof.dr. Jahja Drançolli),
13. Bija shqiptare-Nëna Tereze - tani shenjtëreshë e dashurisë (1910-1997)(referues Dr.Dom Lush Gjergji),

14. Një jubile i madh për kulturën shqiptare (referues Prof.dr. Mahmud Hysa),
15. Datë e rëndësishme e historisë sonë (referues Kolë Berisha, kryetar i Parlamentit të Kosovës),
16. Sfidat e Kosovës pas statusit të ri të saj (referues akademik Esat Stavileci),
17. Vilajeti i Kosovës në vitet e para të shek.XX (referues Dr. Shkëlzen Raça),
18. In memoriam: Imzot Mark Sopi(1938-2006), Dr.Ibrahim Rugova(1944-2006), Dr. Engjëll Sedaj(1943-2009), (referues Dom Lush Gjergji),
19. Kosova - rruga drejt Evropës së re (referues Prof.Ass.dr.sc. Agim Zogaj),
20. Kosova dhe perspektiva e saj ekonomike evropiane(referues Prof.dr. Besim Beqaj),
- 21.Kosova dhe perspektiva e saj evropiane(referues Bejtush Isufi),
22. Kosova si pjesë integrale e hartës kulturore të Evropës(referues Mr. Valton Beqiri, Prof.),
23. Shteti dhe identiteti (referues Arben Xhaferi),
24. Islam Pira - bashkëluftëtari më besnik i kreshnikut të Karadakut-Idriz Seferit (referues Prof.dr. Mehmet Halimi),
25. Vepër me peshë historike (referues Prof. Dr. Daut Bislimi),
26. Studim i mirëseardhur për dialektologjinë shqiptare(referues Prof.Dr. Gjovalin Shkurtaj),
27. Letërsia dhe identiteti (referuese Dr. Luljeta Isaku),

28. Dukuria e policentrizmit në letërsinë shqipe (referues Ramadan Musliu),
29. Kultura shtet-formuese shqiptare në dekadën e dytë të shek.XXI (referues Prof. Ass. Dr. Bajram Kosumi),
30. A ka vend për ideale (referues Prof. Dr. Shaban Sinani),
31. Reflektime për "pesë" anarkitë e Nolit dhe për anarkitë tona sot (referues Dr. Skënder Hasani),
32. Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe Kosova(referues Prof.dr. Jahja Drançolli),
33. Skënderbeu dhe Arbëreshët e Italisë (referues Dr. Antonio Belushi ),
34. Letërkëmbimi i Skënderbeut me sulltanët dhe me papët(referues Dr. Mark Palnikaj),
35. Prejardhja e Kastriotëve dhe dilemat rreth prejardhjes së Voisavës, nënës së Skënderbeut (referues Prof. Dr. Muzafer Bislimi),
36. Gjergj Kastrioti Skanderbeg në letërsinë dramatike shqipe (referues Dr. Erenestina Gjergji Halili ),
- 37.Scanderbeg e Venezia (referues Lucia Nadin).

### **2019-2020 -2024**

1. Pjetër Bogdani në studimet shqiptare (referues Prof. Dr. Ymer Çiraku),
2. Lëvrues i prozës shqipe (referues Prof. Dr. Zeqirja Neziri),
3. Vepra e Pjetër Bogdanit dhe poetika e barokut (referues Prof. Dr. Anton Berishaj),

4. Filozofia e Imzot Bogdanit në "CUNEUS PROPHETARUM DE CHRISTO SALVATORE MUNDI), (referuese Dr. Erenestina Halili),
5. Pasqyrimi i toponimeve në veprën "ÇETA E PROFETËVE" të Pjetër Bogdanit (referues Prof. Dr. Mustafa Ibrahim),
6. Imzot Pjetër Bogdani, njeri i Zotit dhe popullit (referues Dom Lush Gjergji),
7. Konstatimi i Madh dhe kthesa e madhe historike e politikës së tij ndaj krishterimit (referues Prof. Dr. Zef Mirdita),
8. Vështrim mbi organizimin kishtar në Dardani (shek. IV-XII), (referues Prof. Dr. Luan Përzhita),
9. Të dhëna mbi krishterimin në Iliri para dhe pas Ediktit të Milanos (referues Prof. Dr. Edmond Malaj ),
10. Edikti i Milanos dhe liria fetare (referues Dr. Lush Gjergji),
11. Shkolla e parë shqipe në Kosovë dhe politika arsimore Austro-Hungareze ndaj territoreve shqiptare (referues Prof. Dr. Kurt Gostentschnigg),
12. Profesor Engjëll Sedaj-një akademi më vete (referues Prof. Franë Gjergji),
13. Jeronimi dhe versionet latine të Shkrimit Shenjt (referues At Flavio Cavalini, OFM),
14. Shën Jeronimi ilir(347-420), (referues Don Lush Gjergji),
15. Shën Jeronimi, shëmbëlltëryë komplekse e gjenit EUSEBIUS SOPFRONIUS HIRONYMUSS (347-420), (referues Prof. Dr. Nebi Islami ),

16. Shën Jeronimi: Epistolet dhe Hagiografia, aspekte zhanrore (referuese Dr. Erenestina Gjergji Halili),
17. Shën Jeronimi dhe bota ilire (referues Mr.Sc. Prend Buzhala),
18. Nëna Tereze -Jetë dhe porosi për popullin tonë (referues Dr. Lush Gjergji),
19. Anton ÇETTA -"Babai i pajtimit" (referues Dr. Lush Gjergji),
20. Shqiptarët ndërmjet ekumenizmit të krishterë dhe frymave islamike (referues Prof. Dr. Nebi Islami).

#### **2024 - edicioni i 35-të-jubilar**

1. Rugova, arkitekt i shtetit të Kosovës (referues Dr. Fatmir Sejdiu),
2. Shteti i Kosovës dhe sfidat e shqiptarëve sot në integrimin evropian (referues Ali Ahmeti),
3. Rugova dhe rëndësia e krijimit të miqësisë ndërkombëtare për Kosovën (referues Besnik Mustafaj),
4. Rugova, model i politikës burimor evropian (referues Luca De Pali).

Siç shohim nga kjo paraqitje, kuptojmë se aty janë paraqitur punonjës të afirmuar të shkencës, të kulturës e të politikës shqiptare të cilët me shumë kompetencë kanë rrahur çështje të nduarnduarta nga historia e kultura jonë e lashtë kombëtare duke dëshmuar kulturën, traditat e zakonet tona të lashta autoktone në trojet tona etnike. Ç'është e vërteta ata kanë marrë në shqyrtim çështje të rëndësishme

të kulturës e të shkencës sonë, duke i kundruar ato nga aspekte të ndryshme, e duke bërë fjalë edhe për personalitete të ndritshme të historisë sonë kombëtare.

## 2) *Ora e madhe letrare*

Siç dihet tashmë, që në vitet e 90-ta, kur kemi filluar të merremi me organizimin e Takimeve të Dom Mikelit, përkatësisht edhe me organizimin e ORËS SË MADHE LETRARE, me propozimin dhe insistimin e Rrok Gjonlleshajt dhe të Engjëll Sedajt, jo rastësisht, mua më është besuar të merrem, jo vetëm me organizimin dhe moderimin, por edhe me përzgjedhjen e poetëve të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës (më vonë u quajt LSHK), që do të lexonin në Orën e Madhe Letrare. Ka ndodhur kështu edhe për faktin së në vitet e 80-ta dhe 90-ta unë isha një ndër emrat më të njohur jo vetëm si politikan por edhe si poet, shkrimtar dhe studiues i letërsisë në Kosovë, madje edhe anëtar i LSHK që nga viti 1972.

Vlen të theksohet se *ora letrare*, që është mbajtur, në kuadër të Takimeve të Dom Mikelit, që nga fillimi (1990) e deri më 2024, e ka pasur peshën, rëndësinë dhe vlerën e vet shumë të veçantë. Nëpër orët letrare të Takimeve të Dom Mikelit, në përzgjedhjen që kam bërë unë, në bashkëpunim me Kryesinë e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, kryetar i së cilës atë botë ishte shoku dhe miku im i shtrenjtë, Dr. Ibrahim Rugova, kanë defiluar dhe lexuar poetët më të mirë jo vetëm të Kosoves. Kanë lexuar me

qindra poetë shumë të njohur jo vetëm të Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Në kuadër të *orës* ka funksionuar edhe Juria profesionale prej tre anëtarëve të cilët i ka caktuar KOTDM.

Poezitë e lexuara të poetëve në këtë aktivitet kulturorë, ato më të mirat, të realizuara artistikisht, janë shpërblyer me çmime të veçanta.

Në Takimet e para të Dom Mikelit (1990-1992-1997-2003), në ORËN E MADHE LETRARE, janë lexuar shumë poezi, disa prej më të mirave po i sjellim këtu për të shijuar sadopak bukurinë estetike të tyre.

### **Statuja e gjallë<sup>7</sup>**

(Dom Mikel Tarabulluzit)

Të preka Gishtërinjë m'u ftohen  
Të pashë Statujë e ngurëzuar Statujë  
Nga qepalla ime lotoi gjumi  
Të thashë Po shpirtëroj në një ngjyrë  
Nëpërmjet brushës sime në studion e vetmuar  
Dhe shih Ti fillove të flasësh në gjuhën time

M`u ngrohën gishtërinjtë në bronx  
Ti ece e zbritë në studion time

---

<sup>7</sup> Takimet e dom Mikelit (1990-1992), Buletini 1994, fq.15.

U ule këmbëkryq e m'i zbulove fshehtësitë  
Nëpër gjurmët e ngjyave nëpër pëlhurë

Ç`shpirtërim i shenjtë ç`shpirtërim  
Të thashë Kthehu nëpër këtë gërmë  
Të të ringjallë në të njëjtën Statujë  
Dhe Ja Ti zbritë në të njëjtën Gërmë  
Dhe unë po flas në gjuhën tënde të shenjtë

*Miradije Ramiqi*

### **Kuotë e lartë<sup>8</sup>**

(Dom Mikel Tarabulluzit)

Në rizgjim krijojmë një Fjalë një Zot  
E t`mejtuar të shohim në përfytyrim  
Bjeshkës kapedane ti i jep bekim  
Dhe engjujve tu në këtë Fushë-Log

Dihatje flatrimi dëgjojmë anëmbanë  
Balli diellndriçuar ish Oguri yt  
Ç`idhin ato dritëra ç`është ai Virtyt  
Nxitoj të rimëztoj sa të të kem pranë

E gjen Udhën dot mësues për në katund

---

<sup>8</sup> Takimet e dom Mikelit (1990-1992), Buletini 1994, fq.60.



Për në Korab lart shtrëngata s'të mund  
Fjala Jote e butë niste shumë vapore

Ndre Stublla të Fliste këtu në Karadak  
Për Palin e Gjonin e Dhembjen Farmak  
Po ti ndizje vetë yjtë mëngjesorë

*Zejnullah Halili*

### **Dialog me mësuesin<sup>9</sup>**

(Dom Mikel Tarabulluzit)

Kur me dekret në Altar të Atdheut  
- në Stubëll të dërguan-  
pesë shekuj jetë të mundimshme  
të Shkollës a nuk gjete

Vallë, a nuk thoshe :  
"Tempull i Zotit  
këtu  
Marshimi i Vetëdijes ...  
s' mund të mbytet "

Edhe përkundër të gjitha mynxyrave  
shqip dëftohet:

---

<sup>9</sup> Takimet e dom Mikelit (1990-1992), Buletini 1994, fq.76.

Ne ekzistojmë...

*Sarë Gjergji*

**Kosova**<sup>10</sup>

E brishtë  
si kërcyelli i barit  
nën peshën e fjalës  
lakohet  
me gënjeshtren  
që çpon trupin

Në vend të gjetheve  
fjalë të zbrazëta  
shushurisin  
në horizont  
ku mund të lind Dielli

ndërsa guri i mullirit  
bluan shpresat  
deri në vdekje

Zemërimi i yjeve  
Hijeson

*Isak Ahmeti*

---

<sup>10</sup> Takimet e dom Mikelit (1997-2003, Buletini IV, 2004.

Në vijim kemi poezitë e shpërblyera me çmimin "AGIM RAMADANI"

### **Letra e dom Mikel Tarabulluzit<sup>11</sup>**

Tue e ditun fort mirë se edhe nata kishte veshë  
me ndigjue si kjoftëlargu mbas gardhit t'shpisë  
dom Mikel Tarabulluzi nuk u zmbrops asnji hap  
nji ditë e muer nji copë letër dhe nji laps në dorë  
me i shkruie kryeipeshkvit të Shkupit, Lazër Mjedës  
siç ish zotue n' emën t' Atit, Birit e Shpirtit t'Shenjt  
qysh në krye të herës nisi me e kshillue me urtësi  
se Hyjit duhet me iu lutë vetëm n' gjuhën e nanës  
tokës me i thanë tokë, bukës bukë e djellit djell  
megjithëse ishin shtue s'tepërmi hijet e shtrugave  
e pothujse nuk u shpëtonte asgja që ndodhte duku  
nuk e vrau mendjen se ç'gjamë mun t'i binte në krye  
mbas nji kohe Lazër Mjeda u befasue kur e mori letrën  
sa çel e mshel sytëe lexoi kundruell zjarrit t'ndexun  
iu duk sikur ia shkruie kryekëput me dorën e vet  
i ra ndër mend se qysh moti ish betue para Tynëzot  
se tanë jetën e lume do t'i lutej vetëm n'gjuhën e vendit  
por tevona seç ranë mjegullat e zeza mbi udhën e tij  
e mbasandej ia behën shpejt edhe ulurima e frikshme  
ban çmos me ia mbyllë gojën me hekur e zharm

---

<sup>11</sup> Poezia e shpërblyer me çmimin e parë "Agim Ramadani".

dhe nji ditë ia dolën djajtë me e zbutë nga Shkupi  
me e lanë arqipeshkinë me u fikë si zjarri në votër  
dhe Hyjit që kqyrte nga qielli mos me iu lutë askush  
n'gjuhën e lashtë që e kuptonin edhe gurt ' e zogjtë.

*Ahmet Selmani*

### **Këngë gege<sup>12</sup>**

Nuk di ku nis e ku përfundon me xë të hollë  
një këngë e vjetër gege dhe unë puth heshtur sytë e tu  
e përroska e vigël, bri dritares,  
lyer me ngjyrë kobalti, si të gjitha ditët tona,  
merr këngën tënde me vete, ta ruaj në dejtë e vijëzuar,  
si rrugica të zeza në gjethe lisash,  
si rrugica të bardha brenda njollave të gjakut  
dhe ti prapë e këndon të njëjtën këngë të vjetër  
me zë të hollë  
sa herë digjem, sa për tri mëhallë me zjarre dimri...  
sa herë që momenti i kujtimit tim ulet  
e pi ujë burimi në të,  
dhe them, vizato fushat e kodrat që po lëvizin  
rrudhave të ballit yim! Po lëvizin pandërprerë,  
por kur do të ndalen, atëbotë shpagimi i çdo gjëje,  
dashuni do të jetë.

---

<sup>12</sup> Poezia e shpërblyer me çmimin e dytë "Agim Ramadani".

*Zade Kuqi*

### **Troja në tri kohë<sup>13</sup>**

Çapitem mes rrënojave të Trojës  
këto gërmadha më flasin me memecërinë e tyre.  
Por unë dua zërin tënd të kthjellët  
si shndritja e shkëlqimi ageve të këtij qytetërimi  
para se të kishte një Parid e Helenë.

Para se deti të ishte tërheqë në thellësi të tij,  
si një përbindësh i tërbuar nga tmerri,  
ku paqen e gjen në vërbëri dhe heshtje  
për të mos dëshmuar tradhtinë,  
as dashuritë e mëdha të lëna përgjysmë,  
as zjarrin e kasaphanën e natës së kalit:  
as shpinën e kreshpëruar dallgësh,  
kur barti heronj e viktima  
nëpër të njëjtat shtigje ujërash,  
por të shënuara nga ora e lundrimit:  
Disa të gjakuara nga rrjedha e dejve trojan;  
Të tjerat të metalta nga tringëllima monedhash  
e hires robinjash trofesh akeje.

Çapitem mes rrënojave të Trojës,  
pënguar mes përgjesh shpatash të ndryshkura,  
E harruar mes tyre, një guaskë nga deti i dikurshëm

---

<sup>13</sup> Poezia e shpërblyer me çmimin e tretë "Agim Ramadani".

si shpresë për të mësuar të pathënat e sekretet.

Tek kjo guaskë është strehuar tingulli.  
Me zë, Muret e Trojës së Rrëthuar,  
la dërhoj Helenës së shekujve të ardhshëm...

*Dr. Irena Gjoni*

### **Testament<sup>14</sup>**

Pa asnjë mëdyshje, i la trashëgim shpirtit  
vijat që gërdhishta me gozhdë mbi mur  
sa herë mata shtatin n'prag përvjetorësh.  
Psketën e gjysmueme Lucky Strike, bashkë me çakmakun  
që don fërkue disa herë derisa t' kallet  
Bllokun e poezive e që shkrova ndër autobuzat  
e çoroditun nga tallavaja e altoparlantëve  
t' vumë kithtas me valavitjen e perdeve.  
Inicialet e ish të dashunve  
t'stibuem di teshat që s'u bjen ma rasti me u veshë.  
Sirtarin e ndërresave me dy-tri palë mbathje në qoshe  
që i ruajta për takimet e pamujtuna.  
Ato këpucët me gomë të trashë e lidhse t'bame ny  
që mbatha në rrugtimet e mia t'pacake.  
Tana netët pa gjumë kur prita agun

---

<sup>14</sup> Poezia e shpërblyer me çmimin e tretë “Agim Ramadani”.

cullak apo e pshtjellun me jorganin e pajës.  
Fjalëkalimet virtuale t'sajume me emna e data  
t'shenjueme trishtas ndër kalendarë t'kahershëm.  
Shpirtit i la trashëgim edhe arkivën e imazheve  
të gdhenduna ndër retina,  
prejse s'mbërrita me i fiksue në aparatin fotografik,  
t'varun si patku në derën e shpisë me luleborë...

*Rozafa Shpuza*

### **Një ligjeratë e një plake në ditën e Shën Premtes<sup>15</sup>**

*Rruzarja e Parë*

Mos harro

Emni i Gjergjit, i atij t'moçmit, nga Loza e Kastriotëve,  
asht trashëgues i rranjls sonë, i emnit tonë e i gjakut tonl.  
Emnin e tij na e përmendim  
e, e përtrijmë në martesë e jur bajmë kunorë te lteri,  
ditën e Zisë, kur i çojmë nl vorr ma t'dashtunit  
dhe në ato dekika, kur na humbin e na qesin fare.  
E pagëzojmë fëmijën tonë dhe lidhemi me Gjergjin tonë,  
kur e dhezim zjarmin n'calik t'votrës  
a qirin për festa e për Shëngjergj,  
kur i lulojmë dyert me lulet e Shëngjergjit.

---

<sup>15</sup> Poezia e shpërblyer me çmimin "Agim Ramadani"

Nga një Gjergj e kemi pasë në krejt ato tefteret e ushtrive  
t'hueja,  
kur na i kanë marrë djemtë nëpër ushtri t'veta,  
nëpër hapsane,  
kur na i kanë ba sejmenë t'pashallarëve,

a kur na i kanë degdisësi asqerë e jeniçer n' Jemen a n'  
Anadolli.

Nga një Gjergj e kishim, kur na e varshin një njeri n' konop  
A kur e vrasin mbas shpine, .  
E hala e varin e, e mbysin.

### *Rruzarja e Dytë*

Mos harro  
kush asht tash edhe ky Gjergji ynë,  
djali ynë, që e çuem n'kishë?  
Tash e shohim, tash s'e shohim.  
Na fëmijëve e nipave ju kallëzojmë  
bash ato kallëzime ma t'bukues për Gjergjin tonë.  
Secili thotë:unë e kam emnin Gjergj.  
E pra, na emnat i kemi krejt ndryshe,  
po te krejt këta emna asht ai emën.  
Te emnat e të dekunve e te emnat e t'gjallëve.  
Ai asht te emnat e shumë vorreve  
e te emnat e shumë kishave,  
te emnat e kullave, maleve, ujnave,  
te emnat e luleve e te emnat e festave.



Te shumë kryqe mbi Dhe e nën Dhe.  
Te emnat e cubave t'malit .  
Asht i mfshehun, t'duket sa humbi krejt,  
e mandej krejt pa pritë e pa kujtue,  
ngjallet e bahet ushtarë  
e, ua nxen pritën zabitve t'mbretit.  
Çon peshë një krahinë dhe e dhezë një luftë.

### *Rruzarja e Tretë*

Mos harro  
nga një Gjergj  
për me peshue me emëb e trimni,  
e kem nxjerrë n'secilën kohë.  
Kush don me e kërkue Gjergjin, ka me e gjetë te emni i vet.

### *Prend Buzhala*

### **Motrat e Heliosit<sup>16</sup>**

Ajo mund të mos hynte lehtë  
në përjetësi  
edhe nëse gishtat  
do t'i pikonin ambrozi

Fjalë oborrtare

---

<sup>16</sup> Poezia e shpërblyer me çmimin e dytë "Agim Ramadani".

u flaktë si lajkat  
më buk mund ta shikosh  
me bisht syri  
as me dhurata pa dashuri  
se është motër

Kupat e holla  
si brishtësia e gishtave  
perëndishtë e dhembshme  
Motra e Heliosit  
Motra e Mikelit  
Motra e Besnikut

Kush s'ia pa  
delikatesën e së kaltrës së syrit  
vëlla ku i ke shokët  
e fal njërin e fal tjetrin

Nuk i bën dot psikologji motrës  
së luftëtarit  
se e ruan madhështia pa idil

Mos luani e bëni nishane  
përukje pa fre llogari e fantazi  
nuk e ndëshkon vajtimi

hiri i Zotit e shkruan kurajën

Është motra e luftëtarit të hershëm  
që s'arriti të merrte gradë

*Naime Beqiraj*

### **Proleps<sup>17</sup>**

Në frymën e diellit linde  
Shenjtërisht  
Un riktheve foltoreve  
Mrizeve  
Bukurinë e jetesës  
Shkallmuan

O Zot  
Fijen e mallit  
Librin e jetës  
Mashtruam

Puthjen e qiellit  
Lakoren e Fatit harruam  
Në Jetë Oshënare  
Pamja  
Kaosi  
E mashtroi rrehullin  
Prishi hijen  
Fijen e universit

---

<sup>17</sup> Poezia e shpërblyer me çmimin e parë "Agim Ramadani".

Zoti im që rri në qiell  
Mëkatin shpirtëror  
Rigjallëruam  
Asnjë bukuri nuk e ndali rikthimin  
Në gurin e moçëm  
Të shenjtin Topos  
Prolepsën metaforë  
Harruam

Zot  
Kush i ndjeu më mirë se ti  
Shekujt e furtunës  
Nuk e shënoj frymën  
Moshën Oshënare  
Testamenti  
Ah testamentin  
që rriti shtat  
E pikëllim

Tash ngadalë përtype hidhërimin  
Me mallin dhe shenjtërinë  
Rrëpirtas Dhjatë  
Në bukurinë e zezë  
Thure universin  
Trishtueshëm  
Fatin tim

*Flamur Maloku*

## **Bija e Marëndorit<sup>18</sup>**

(baladë )

Vargut të martirëve të Karadakut, që turqit në shek. XIX e nisën në këmbë, prej Kosove në Stamboll për t'ua ndërruar fenë. Këta njerëz që nuk i mbrojti as Vatikani, i zbuloi një organizatë humanitare franceze që vepronte në Stamboll. Unë e shkëputa nga ky varg një nuse të re, Diellën e Andresë prej fshatit Marëndor të Stubllës. U mundova të ia falë këngën time.

E treta në rend

Mbi të mbathët shkrua gegënisht

Si bukë e magjes ligë, thembra e plasë fitil

Ecë me hap të imët, e ulë në gjak shputë e saj

Pluhurin valë në More

Hapë gjishtin me drojë. Gushë e njomë i bie mbi te

Se ku e pashë, po i tha ; medaljoni palë nën te

Unë jam Diella e Andresë .Më thonë edhe bija e Marëndorit

Ka 'i herë

Kur e hedh farën n' ugarë, vekun kur e sos,

Mërika e Nuni kur m`lenë

Shtatëmbëdhjetë s'i pata krejt, i lau gjaku i shtatit tem

Haaajt bija e Marëndorit! Më thanë.

Trembet vargu nën kamxhik .E shtat' a 'teta në rend.

---

<sup>18</sup> Poezia e shpërblyer me çmimin e dytë "Agim Ramadani".

I nëm këmbët që s' më bëjnë. Buzëb vred e njomë në guriç  
Diella e Andresë .

Hapi gjirin vrik., si dorë kalli ra mbi te gërshetë e artë.

Se ku e ndjeva, po i tha nedaljonit në gji valë.

E Bekueme, Mrikën e Nunin i lashë,

Bukën me thye s'dinë

Tojat m'i lidhë s' mbërtijnë

Kryet m'e la s'ka kush u qet

Kohën meshës s'ia mbajnë n'mend,

Zot, ruje Andrenë.

Në ara shterpa i' karvan .Mjegull vapë n' Anadoll.

E shtat ' a' tetëmbëdhjeta në rend, bija e Marëndorit.

Se ku e ndjeva po i tha, medaljoni ulur më djersë

Shën Mëri e Lumja Zojë.

Unë s'jam grue për asken, pos n'oborr me rozmary

Ku qet flladi shtog e mokth jam e dashtuna e Andresë

Djalë e çikë i kam me te. Aso bukurie s'ka.

E shtatë tetëdhjeta në rend, Bija e Marënforit

E shqeu këmishën lër grykë

I këpuyi tojat në pështjellak

Kur e çeli shkrumbin në gaz.

I mbuloi gjaku dhëmbët e bardhë, pak pa i thanë Fatime

Pak pa u hedhë në Karadenis, bëri kryq kryq edhe njëherë

DOMINUS VOBISKUM tha.

*Hida Halimi*

## Stublla<sup>19</sup>

Drapëri vigan i një gjysmëhëne  
ia korri kallingjtë  
dhe të lashtat e fushës  
asesi të mbjellat e Shën Jeronimit  
për të gdhendur gurin

stubllasit u gjetën këtu  
pështymën t'ua lanin retë  
lakadredhash me çelës  
të kryqit në tru

Stublla nuk është Krujë  
Kruja nuk është Stubëll  
atje nuk është Gjergji në burbujë  
këtij i zmadhohet një sumbull

Ajo sheh azurinën  
e avujve të tretjes së shikimeve  
ato të fismet e princërve

prore e avullt nga lartësia  
shihet largësia

sogjetorja përgjon

---

<sup>19</sup> Poezia e shpërblyer me çmimin e tretë "Agim Ramadani".

kumti mungon  
në Muzeun e Gjergjit  
shurdhësive të këmbanës  
ilahit kalërojnë  
në Stubëll kambana kumbon  
deri te "Martirët e Karadakut"  
dhe diaspora  
për lutjet shqip të mëngjesit

vijmë e ngjitemi lart te ndërdija  
kjo përshpirtërsi e ka trazuar  
kthehemi poshtë të ngopur me muzgun  
me sedër të hibridizuar  
lakminë e lehtë të ngrënies  
duke gromsuar

Stublla e ka arkitektuar sedrën e vet

se si kobcepti i zverdhjes  
skuqet shpërthen fuqinë e verës  
dhjetëra sylynjanë  
në shpirt më derdhen  
jo si fondvere  
as fillimvjeshte  
as motive vjershe

gjethet e hibridit të ri  
bien nga kjo lartësi



Stublla fsheh dishepullin  
e ngjizjes së kërthizës  
te "Agim i gjytetnis"

bashkë me korin e bekuar  
Hirësia e Tij don Mikel  
dhe lutësit e mëkatuar

Inzot  
mos na lërë  
të biem në ferr  
të katër sopatave cirilike  
ka a s'ka urata epike  
mes Hirësisë Suaj e Perëndisë  
le të firmoset kontrata e etnisë

në Stubëll hyri Krishti  
dhe këmbëzën e djallit  
nuk e shkrepj gishti

*Mehmetali Rexhepi*

### **Loti i Tamarës<sup>20</sup>**

Të desha veç në kujtime, zjarri im i heshtur

---

<sup>20</sup> Poeza e shpërblyer me çmimin e parë "Agim Ramadani".

por fatin e gruas së vejë kurrë s'ta urova  
Ishte e pa prekur ura e kalimit  
kur ti kishe ëndërr, por jo edhe moshë  
çudi, një portë qielli gjithmonë mbet e hapur

Ta ndjeva fluturimin brenda ëndrrës femërore  
por ato ditë "syri" kishte vetëm një shikim  
si lodër dhembjeje u shpërrua shpirti yt  
po shpirti me shpirt kurrë s'bëri lojë  
të gjitha dëshirat e vashave ato ditë  
qenë ngjizur veç në një pasqyrë  
por "flokun" i Samsonit mbeti i pa prerë...

Lundrova me ty, por jo me erën e dashurisë  
sepse fjala jote për mua nuk qe ëndërr  
kaluan vitet si Dielli -i freskët  
por asnjëri nga ne kurrë nuk u mplak  
ta ndjeva gjëmën e vajtimin para dy vsrres  
të gjysmës tënde  
po flakë që vret qenka vajza kurrë e bërë nuse  
Tamara, mos ia trego ëndrrën vajzës që të pret në qiell  
Po as burri që kurrë s'të pyeti për ëndrrën...

*Vilson Culaj*

## Qytete të nëndheshme ilire<sup>21</sup>

Qytete të nëndheshme ilire  
Mos na mbani për të huaj  
Kur të trokasim në dyert tuaja  
Dhe dyert na i hapni  
Ç'e ligë që na gjeti OH  
Copë-copë na dëftoheni gërmadhave  
Fragmente tuaja na dalin para ditë më ditë

Ç'bëmë Oh ç'bëmë që qytete të tjera  
Ngriten mbi ju nga malli që kishim  
Në rrugët dhe sheshet tuaja  
Dhe ju shtymë në legjenda  
Mbase keni frikë mos u vijnë armiqtë  
Por mos jipni alarme  
Do të na njihni posa të dëgjoni  
Fjalët tuaja ilirisht  
Që nuk ranë kurrë  
Jetuan arbërisht  
Dhe botën msrrin shqip

*Qerim Ujkani*

---

<sup>21</sup> Poezia e shpërblyer me çmimin e parë "Agim Ramadani".

## **Karadak mahalla<sup>22</sup>**

Shkup.Karadak Mahallë.

Tani dhe këtu, ku ke lindur Ti,

lindi kuptimi abstrakt i vendlindjes.

Në vend të shtëpive përdhese që u braktisen

me dallendyshe dhe u zbarkuan në Turqi,

atje rash betoni përcëllon dhe dielli shkrep së prapthi.

Dhe, ata të cilët paditnin për uzurpim urbanistik,

(projektantë të asimilimit të shqiptarëve ),

masonë dhe shkelës të të drejtave njerëzore,

me dekada shpërndajnë letra nëpër sirtarë kabinetesh

nëpër

qendrat e vendosjes, duke mbjellur

hi e vdekje, artefakte që

djegin thellë

gjallë

Karadak Mahallë, kujtim që rrokullisesh dikund në Jeshil

Tepe e

Çanak-Kala në gjuhë të çalë shqipe

që kujtohesh nga 1839 1878 1913 1918

1957 1981 etj.

si vjedhëse e kohës së kripë dhe kuajve fluturues

që me kallëfe prej sateni fluturuan, ikën prej zullumit të

shkijeve dhe u plandisen në një planet tjetër,

---

<sup>22</sup> Poezia e shpërblyer me çmimin e parë "Shën Jeronimi".

atje ku u fishk Karadak Mahalla,  
u asimiluan shqiptarët u bënë turqër,  
dhe mbet relik i gjaku dhe shpirti i asaj kohe  
shndërruar në një ujë tjetër .  
Kurse tani, të gjithë mbledhësit e hirit e të purpurit  
të thonë se këtu pate lindur  
Ti.

Po. Këtu pate lindur Ti.

Unë atëherë isha njëvjeçar dhe s'dija se do të vish  
në botë, por ta kisha ndjerë ardhjen e largët,  
ta kisha parë hijen e Doruntinës në rruzull,  
ta kisha vizatuar itinerarin o j Bukuri që s'vdes kurrë,  
bukuri që ndjehesh dhe prekesh .E kur një ditë  
do të vish dhe unë nuk do të jem më, mua  
do të më gjes në fluturimin e Ikarit, në trokun Pegasit,  
kalit flutur, në shelgun vajtues që tmerrisht të don  
edhe sot. Ty. Po, Ti këtu pa lindur,  
kurse koha ka vapën e një sirene që don të na mërgojë  
në një substancë tjetër që s'mund ta bluajë  
asnjë krematorium.

*Nehas Sopaj*

### **Njeriu prej shalli<sup>23</sup>**

Ti kallëzove që po ikën  
Unë sigurova një qiri  
Të t'i bëj dritë shpirtit

Njeriu është sall udhë .The  
Në majë të gishtërinjve po eci  
Një fjalë t'ia çoj Bogdanit

Shallin lere mbi derë t`lutem  
Të luhatet mbi prag shtëpie  
Ta ruaj kujtimin për ty

*Bardh Frangu*

### **Rrugë e pagjetur<sup>24</sup>**

Luftërat kanë humbur rrugën  
sillen vërdallë sipër reshë të zeza  
do grisë kokën një re e bardhë  
që kundron fundin e një plani shfarosës  
në paragraf klasifikon kohërat e humbura  
kur zjarri përqafonte ujërat përdëllueshëm  
acar në lule hedh qenia e vetëquajtur njer

---

<sup>23</sup> Poezia e shpërblyer me çmimin e dytë "Shën Jeronimi".

<sup>24</sup> Poezia e shpërblyer me çmimin e tretë "Shën Jeronimi".

acar në shpirtra që rendin në mbijetim  
ide e prerë në besueshmëri  
silueta e njeriut me nofulla dinozauri  
pasqyrë në histori  
përulet Antarktida me respekt

Saharës i shërben me freski ujërash përmbytëse  
kjo e shpërblen me vapë zjarri  
pangopësia  
të dyja i vë në një lugë  
kurse tlrë globin në pjatën e saj ende të palarë  
ah, ti njeri  
soditë në heshtje arkivolin tënd  
dhe si ditë në kornizat e tij  
vezullimin e rrejshëm të një perle  
që të nxit drejt rrugëve të bllokuara  
si një prijës i verbër deshtak

*Dritë Maxhuni*

**Ejlli<sup>25</sup>**

(In memoriam Dom Mikelit)

Thirre ejllin tënd, kur dita t'përhimë t'ka deshë  
bani za, se ejlli merr f'yyrën e nënës, bsbës, dheut.

---

<sup>25</sup> Poezia e shpërblyer me çmimin e parë "Agim Ramadani".

Thirre ejllin tënd kur mushknia t'ka pre n'besë  
Ora pro nobis, ora pro nobis  
Nanë do të jetë  
Babë do të jetë  
Atdhe do të jetë  
Bani za ejllit kur këmbë e huej t'shkel mbi koc  
mbi shpinë tënden kryqin ka lënë dhej  
se lodin tënd e mbledh n'Gral t'fildishtë,  
m'u ngijë sofa e dëshmisë njerëzore  
Ora pro nobis Ora pro nobis...

Ernestina Gjergji Halili

### **Tek Ati ynë në Lezhë<sup>26</sup>**

O At i Madh  
që shndrit shtatë palë qiell  
për ta lumturuar këtë tokë  
Para teje jam gatitu  
si dje  
si sot  
si nesër

Përmes shpirtit tim  
bekimin tënd kërkoj  
atë bekim dëshiroj

---

<sup>26</sup> Poezia e shpërblyer me çmimin e dytë "Agim Ramadani".



Bekomë o At  
për Dheun e Arbërit  
gjakun tonë  
një punë të mirë  
ta bëj dhe unë  
O Ati ynë  
Ti më dëgjon  
edhe kur heshti  
edhe kur flas  
Bekomë bekomë bekomë

Me bekimin tënd o At  
po nisem e s' do të ndalem  
deri në frymën e mbramë  
për t'ia çelur udhën këtij gjaku  
Le të rrjedhë ku deshe Ti  
Ku deshe Ti  
rrjedh  
O At  
me emrin e për emrin Tënd  
nëpër dejtë e trupit arbëror  
o bekues  
i secilës Epokë  
dhe të hspit që bëj  
të frymës që thithi or e çast  
Ti  
At i mbrojtjes  
i paqes e i lirisë

Përjetësisht të falem  
për atë që na dhe  
Nën Dhe e mbi Dhe

*Sabit Rrustemi*

### **Sikur<sup>27</sup>**

Sikur ta dija se do të mund të vije  
Unë do të dilja në Krujë  
Me bucelën në dorë  
Me Xhinset veshur  
E me atlete Nike  
Do të prisja e heshtur si fije bari  
Net e ditë të tëra do i fusja vrimës së gjilpërës  
Duke bërë udhën për ty

Vetëm të më rrëfeje për Adrianopojën  
Dhe atë vashën që desh e mbyti Sulltanin për Ty  
Me sytë e mi do ta shkëlqejta t'heun e shpatës  
Duke e mbajtur për brinjë të përkrenares

Me Xhinse e patika Nike

---

<sup>27</sup> Poezia e shpërblyer në çmimin e tretë "Agim Ramadani".

Sikur ta dija  
Se sërish mund të ktheje kënde

*Qibrije Demiri-Frangu*

### **Dallgë<sup>28</sup>**

Do të mësoj të.bëhesh si unë më the  
Duhanpirëse, ta djegim shkumb të nxjerrim.  
Të pimë, të dehemi këmbët mos t'i lëmë mbi tokë.  
Të rrimë natën zgjuar, të shohim yjet e ti kapim  
Të ndjekim hënën.  
Të kacafytemi deri në mëngjes  
Të mbytemi deri sa lëngjët të na thahen.  
Dhe të çelemi bashkë me oksigjenine marrëzisë.  
Më deshe shumë, shumë fort  
Aq sa kishe frikë të më dashuroje.  
Mos u shtir se i di të gjitha.  
Pranove dhimbjen që të theri dhpirtin,  
Sa sytë xixa të lëshonin.  
Nuk prita për të bërë dashuri me ty.  
Por rashë në dashuri dhe i bëra gjëmën vetes.  
Nëse jam tani mbi lëkurën tënde,  
Gjeta limanin e ëndrrës!  
Ja ku më ke,

---

<sup>28</sup> Poezia e shpërblye me çmimin e tretë "Agim Ramadani".

Përbri,  
Përballë  
Nuk do të kyç asnjë çmenduri.  
Me të gjitha turpet e trupit do të tallem.  
Nuk iu fsheha botës,  
As ti, madje në sy të botës,  
Më këndoje  
Më gëzoje,  
Me lumturinë!  
Të mekur ngulem.thonjtë drejt aventurës.  
Për ditët tona plot dallgë.  
Për netët tona të rrezikshme!

*Eva Tafa*

### **Kostoja e jetës<sup>29</sup>**

Në këtë botë të bukur e të vrazhdë  
si erdhi njerëzimi, askush s'e do  
ca të verdhë ca të zi, e ca të bardhë

Numri s'dihet se sa, s'dihet se ss

Të mjerët kurrë s'e kuptuan njëri tjetrin

---

<sup>29</sup>Poezia e shpërblyer me çmimin e tretë "Agim Ramadani".

dhe Zoti tokën që moti ua fali pa qira  
ata i ngatërruan lutjet para Zotit  
të gjithë vrapuan rrëmbyeshëm  
kush më shumë të gllabërojë tokën

S'dihet se sa, s'dihet se sa

Si bishat u hëngrën në mes veti  
u ngatërruan shpesh në horizont  
koston e jetës e shtrenjtuan tepër  
dhe vlerën e njeriut e ulën poshtë

S' dihet se sa, s'dihet se sa

Tani tokën e Zotit e shesin mes veti  
dhe ia hipin qiranë pa kufi njëri tjetrit  
Shpesh edhe vriten vëlla me vëlla  
Numri i vrasjeve është tepër i madh

S'dihet se sa, s'dihet se sa

Bajlozët e zinj erdhën e shkuan  
i krekosën për imazhe të rrejshme  
pa ngritur kokën të shkojnë  
vdekje fëmijësh, pleqsh e plaka

S'dihet se sa, s'dihet se sa

Eh ju Bajlozët e sodit me plot magji  
mos prisni Gjergji sërish të rroki shpatën  
Se kokat tuaja do ikin përsëri dhe

S'do dihet se sa, s'do dihet se sa

Kur të pini nga një gotë verë  
dërgojeni një gotë ujë në Afrikë  
kur të ngiheni nga luksi  
çojeni një bukë në Etiopi  
kur të ndërtoni shtëpi luksoze  
çojeni një gur mermeri në Kosovë  
atje gjaku është i freskët  
mbushur me dëshmorë

S'dihet se sa, s' dihet se sa

Ju nuk e njihni Kosovën  
Është trung i Arbërisë  
Shkatërrimi nisi që në Rozafë  
Kur dy vëllezër tradhtuan njërin vëlla  
Tradhtis zgjati me shekuj

S'dihet se sa, s' dihet se sa

Ty, Agim Ramadani, vetëm hëna ta di plagën tënde  
dasma e jote bëri jehonë gjithandej  
Anakondën e fitove, po se po

por oborri na është mbushur me gjsrperinj  
sërish gjaku i arbrit mbetet i lodhur nga horrat

S'dihet se sa, s'dihet se sa

Agim vëlla, gjigantë vriten me plumba  
jo nga bisha e madhe, por nga fisi pa farë  
njëri vritet me të qeshur, tjetri me fjalë  
kështu na u vra jeta, që nga Rozafa  
kur dy vëllezër tradhtuan njërin vëlla  
kështu, kështu u tradhtuam  
dhe u vramë vëllai me vëllanë

Numri s'dihet se sa, s'dihet se sa

Kalimtarë të heshtur s'guxojmë të mbetemi  
që edhe një shekull të na dëgjohen vetëm psherëtima  
kam frikë nga mallkimi nënës së dëshmorit  
më tremb edhe zëri i foshnjës kur qanë për pak qumësht  
mu për këtë, në lumin e shekujve lotët na vriten për gurët

S'dihet se sa, s'dihet se sa

*Ejup Ajdini*

## **E sigurtë është vetëm vdekja<sup>30</sup>**

Nuk është e sigurt  
Në më deshi më shumë se veten

Nuk është e sigurt  
Nëse deshi më shumë se veten

Nuk është e sigurt  
E ndoqën sigurinë nga unë  
Apo e humba rrugës

Nuk është e sigurt  
Ka sigurimi fytyrë burri  
A bishë të trembur

Jam një shuk drite  
Apo njeri prej mishi e gjaku

Nuk është e sigurt  
Po e shkruaj unë këtë vjershë  
Po i shtyp unë shkronjat në tastierë  
Këtë.as sigurimi s'mund ta dijë

Nuk është e sigurt  
Do të vdes në shtrat  
Apo do të më vrasin

---

<sup>30</sup> Poezia është shpërblyer me çmimin e parë "Agim Ramadani".



E sigurt është se dua  
Të kem këmishë të bardhë  
Të bjerë më shumë në sy gjaku

Nuk është e sigurt  
Ç'do të bëhet me sigurinë e brendshme  
Do të ma kthejnë një ditë  
Apo do ta nxjerrin në treg

Nuk është e sigurt  
Më përgjojnë telefonin  
Apo ai jehon vetiu

Nuk është e sigurt  
Cilën ditë do të më nxjerrin  
Prapë në gjyq  
Apo më parë do të më marrin në hetime

Nuk është e sigurt  
Cilin rrugaç cilën kurvë  
Do ta ndërsejnë nesër kundër

Nuk është e sigurt  
Se nuk do të djersij  
Se nuk do të pëlças

E sigurt është vetëm vdekja

Dhe ringjallja poashtu

*Abdullah Konushevc*

### **Amaneti i bashkimit<sup>31</sup>**

Një lajm që vjen letërgrisor  
Rrëzon kullën e lumturisë  
Në shtëpinë e kuqe pa pullaz

Një mort që mbyllë një derë  
Dhe hapë portat e pallateve të Atdheut

Një jetë me një mbarim  
Dhe një fillim i gjatë në rrugën e lirisë

Një dashuri me një amanet pa mbarim  
Që thërret prore  
Bashkim, bashkim, bashkim...

*Sevdail Demiri*

---

<sup>31</sup> Poezia e shpërblyer me çmimin "Agim Ramadani"

## Vitori i andrrës t`eme<sup>32</sup>

Ambësisht do t'puthemi si flmijë  
Dashuria do t' metet n'ledhsyim t'flokëve tona  
Do t'mbaj n'mend si yll i mbrëmjes pa mbarim

Si diellin veror q'i përcëllon  
Si detin e rrëmbyem q'i merr jeta matanë

Do t'mbaj mend si qiellin qi mban fshehtësitë e botës për  
vete  
Do t'mbaj mend di natën, si natën e egër q'i pret ta gëlltisë  
dikë, por vdes urie

Do t'mbaj mend si dimnin e acartë në shpirtin e stinës  
Do t'mbaj mend si dhembjen e nanës për fëmiun

Do t'mbaj mend si trishtimin pas humbjes së një dashurie

Po kurrë s'do t'mbaj mend si yll në qiellin t'em  
As si lule n'kopshtin t'em  
As si figurë n'vargun t em  
As si pikëllim n'kujtimet e mia

S'do t'mbaj mend gjatë, se ti ike...  
Ike...bashkë me trishtimin e humbjes

---

<sup>32</sup> Poezia e shpërblyer me çmimin e parë "Agim Ramadani".

Dhe ty kurrë s'do t'mbaj mend për dashuritë e rrëfyeme

Nji dit' do t'kujtoj se si ikin njerëzit ngs kjo botë e egër  
Duke mos ditur kurrë ç'edhtë dashuria

*Lonora Bruçaj-Keka*

## SHËNIMET E PËRVJETORËVE

Siç shihet edhe nga vetë titulli i temave të shtjelluara dhe të referuara në AKADEMINË SHKENCORE, kuptojmë se ato janë ndërlidhur kryesisht me përvjetorët më të rëndësishëm të historisë dhe kulturës sonë gjatë shekujve.

Natyrisht se Këshilli Organizativ i Takimeve është përkujdesur vazhdimisht, madje me shumë përkushtim, për shënimin e përvjetorëve të rëndësishëm. Kështu për shembull jo rastësisht janë shënuar këta përvjetorë:

1. 300 vjetori i Kuvendit të Arbërit,
  2. 100 vjetori i Pavarësisë, më ç' rast është nënshkruar edhe një Deklaratë, përmbajtja e së cilës është historike,
  3. 450 vjetori i botimit të "Mesharit",
  4. 100 vjetori i lindjes së Nënë Terezës,
  5. 550 vjetori i kalimit në përjetësi të Gjergj Kastriotit,
  6. 150 vjetori i lindjes së Gjergj Fishtës,
  7. Në 330 vjetorin e kalimit në amshim të Pjetër Bogdanit,
  7. Shënimi i përvjetorit të Konstatinit të Madh,
  8. Shënimi i 2000 vjetorit të ktishterimit ndër shqiptarë,
  9. Në 1600 vjetorin e kalimit në amshim të Shën Jeronimit etj. etj.
- E gjithë kjo është një dëshmi e gjallë e kohës!

Krejt në fund të kësaj paraqitjeje dëshiroj t'i informoj lexuesit e kësaj monografie se, me përjashtim të temave

(materialeve) që janë paraqitur dhe referuar në edicionin jubilar (shtator 2024), të gjitha temat e tjera (me ndoj përjashtim të vogël për arsye subjektive!), janë të publikuara te Buletinet si dhe te revistat shkencore: ACADEMIA STUBLLAE, për përgatitjen dhe botimin e të cilave meritën kryesore e kanë Prof. Engjëll Sedaj dhe Prof Sarë Gjergji pa harruar këtu sadopak edhe kontributin tim.

## **SHTOJCË:**

**FOTO TË PËRZGJEDHURA NGA TAKIMET E DOM MIKELIT**















## SHËNIME PER AUTORIN

Isak AHMETI (1946), poet , përkthyes letrar nga gjuha gjermane dhe italiane , studiues i letërsisë , autor i shumë veprave zhanresh të ndryshme , i përfaqësuar në shumë publikime brenda dhe jashtë vendit dhe së fundmi edhe te FJALORI ENCIKLOPEDIK (I-II) ASHA e Kosovës(2018).

Profesor shumëvjeçar në Gjimnazin e Vitisë, ish-kryetar i Komunës së Vitisë (1988-1989), delegat i Kosovës në Kuvendin e Serbisë(1986-1989), anëtar i Akademisë Evropiane të Arteve me seli në Paris, laureat i shumë mirënjohjeve, çmimeve, dhe diplomave, edhe i çmimit prestigjioz dhe Diplomës "Ndre Mjeda" të Qendrës së Studimeve Albanologjike në Tiranës (2013) me motivacion "*Studiues i Letërsisë Shqipe i dalluar për kërkime shkencore rreth jetës dhe veprës së Ndre Mjedës*"(Kukël, 23 Nëntor 2013).

### *Veprat:*

1. Gallatea, poezi, Rilindja, Prishtinë, 1972,
2. Uratë zbulimi, poezi, Rilindja, Prishtinë, 1976,
3. Kushtimebesë, poezi, Rilindja, Prishtinë, 1983,
4. Dritë e përjetësuar, poezi, Prishtinë,2019,
5. Njeri kohës sime, poezi, Salvatore Quasimodo,përkthyer nga italishtja, Rilindja,Prishtinë, 1979,
6. Qumështi i zi i agimit, Lirikë e re gjermane, Rilindja, Prishtinë 1988,

7. Kleri Katolik Shqiptar dhe Letërsia, Ferizaj-Bergamo (Itali), 1994,
8. Kosova, monografi, Prishtinë, 1996,
9. Bibla në Letërsinë Shqiptare, Rilindja, Prishtinë, 1999,
10. Letërsia Kishtare dhe Filozofia e saj, Illyricum Sacrum, Prishtinë, 2000,
11. Weise Zeit (Kohë e bardhë), Lirikë e re gjermane, gjermanisht-shqip, Zym-Has, 2000,
12. Kur`ani në letërsinë shqiptare, botim elektronik, shkodra.net, 2006,
13. Mëvetësi e studimit dhe krijimit të letërsisë, Prishtinë, 2014,
14. Vepër vlerash të mëdha poetike, Prishtinë, 2018,
15. Isak Ahmeti & Marina Grigore: Dashuri e bekuar-lubire binecuvantata, poezi shqip-rumanisht, Bukuresht, 2021,
16. Letërsia Shqiptare e Kosovës, Prishtinë, 2021 ,
17. Golgota e Martirëve Shqiptarë të Karadakut, Prishtinë, 2021,
18. Takimet e Dom Mikelit, monografi, 2024.

